



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Analiza e hulumtimit mbi kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëkërkues dhe punëdhënës nga Agjencia e Punësimit e Kosovës

RAPORTI FINAL

QERSHOR 2020

"Analiza e hulumtimit mbi kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëkërkues dhe punëdhënës nga Agjencia e Punësimit e Kosovës"

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të të anketuarve të hulumtimit dhe nuk i paraqesin domosdoshmërisht pikëmajet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Përmbledhja ekzekutive | 6 |
| Gjetjet kryesore për Punëkërkuessit: | 6 |
| Gjetjet kryesore për Përfaqësuesit e Bizneseve:..... | 7 |
| Hyrje | 8 |
| Metodologjia | 9 |
| Metodologjia Sasiore | 9 |
| Metodologjia për Anketën me Punëkërkuessit | 9 |
| Metodologjia për Anketën me Përfaqësuesit e Bizneseve | 9 |
| Finalizimi i Pyetësorëve..... | 10 |
| Rekrutimi dhe Trajnimi i Ekipit të Anketimit..... | 10 |
| Puna në terren dhe Kontrolli i cilësisë | 10 |
| Pastrimi, Tabulimi dhe Analiza e të Dhënave | 10 |
| Metodologjia Cilësore | 11 |
| Përbërja dhe aktivitetet për intervistat e thelluara:..... | 11 |
| Përparësitë e intervistave të thelluara..... | 11 |
| Transkriptimi | 11 |
| Rezultatet nga Anketa me Punëkërkuessit | 12 |
| Niveli i informacionit me Agjencinë e Punësimit të Kosovës | 12 |
| Masat e marra nga Agjencia e Punësimit e Kosovës | 15 |
| Trajnimet profesionale | 15 |
| Skema e Subvencionimit të Pagave..... | 17 |
| Uebfaqja e Agjencisë së Punësimit të Kosovës | 21 |
| Komentet Përfundimtare për Agjencinë e Punësimit të Kosovës..... | 23 |
| Gjetja e vendeve të punës | 24 |
| Rezultatet nga Anketa dhe Intervistat e Thelluara me Përfaqësuesit e Bizneseve | 26 |
| Rekrutimi i Stafit | 28 |
| Përfundimi | 39 |
| Shtojca A – Pyetësori me Punëkërkuess | 42 |
| Shtojca B – Pyetësori me bizneset | 47 |
| Shtojca C – Lista e bizneseve të anketuara | 54 |
| Shtojca D – Udhëzues për intervista me përfaqësuesit e biznesit | 56 |

Lista e Figurave

| | |
|--|----|
| Figura 1. A mund të na tregoni se ku jeni informuar për Agjencinë e Punësimit? | 12 |
| Figura 2. A keni dëgjuar ndonjëherë për shërbimet / masat e mëposhtme të ofruara nga Zyrat e Punësimit?..... | 13 |
| Figura 3. Cilat ishin arsyet që ju shtynë të regjistroheni në Agjencinë e Punësimit? | 14 |
| Figura 4. Çfarë shërbime keni marr nga Agjencia e Punësimit?..... | 14 |
| Figure 5. Çfarë trajnime profesionale keni ndjekur?..... | 16 |
| Figura 6. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Trajnim profesional..... | 17 |
| Figura 7. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Skema e subvencioneve të pagave..... | 17 |
| Figura 8. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Masa e praktikës | 18 |
| Figura 9. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Masa e trajnimit në vendin e punës..... | 18 |
| Figura 10. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Masa e vetëpunësimit..... | 19 |
| Figura 11. A mund të na tregoni se sa jeni të kënaqur jeni me secilin shërbim që keni marrë nga Zyrat e Punësimit?..... | 19 |
| Figura 12. A mund të na tregoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë me aspektet e mëposhtme në lidhje me punonjësit që punojnë në Zyrën e Punësimit? | 20 |
| Figura 13. A mund të na tregoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë me aspektet e mëposhtme në lidhje me punonjësit që punojnë në Zyrën e Punësimit? Klasifikimi sipas etnisë..... | 21 |
| Figura 14. A keni dëgjuar për platformën (uebfaqen) e Agjencisë së Punësimit e Kosovës, në të cilën publikohen vendet e lira të punës? | 21 |
| Figura 15. Sa shpesh vizitoni uebfaqen e Agjencisë së Punësimit për të gjetur vende të lira të punës? | 22 |
| Figura 16. Sa shpesh vizitoni Uebfaqen e Agjencisë së Punësimit për t'u njoftuar për vendet e lira të punës? Kategorizimi në bazë të moshës | 22 |
| Figura 17. Sa e dobishme mendoni se kjo platformë / faqe në internet është për të papunët? | 23 |
| Figura 18. Sipas mendimit tuaj, si mund të përmirësohen shërbimet e Zyrës së Punësimit? | 23 |
| Figura 19. Bazuar në përvojën tuaj me Agjencinë e Punësimit, a do të rekomandonit që të papunët të regjistrohen në këtë agjenci? | 24 |
| Figura 20. Bazuar në përvojën tuaj me Agjencinë e Punësimit, a do të rekomandonit që të papunët të regjistrohen në këtë agjenci? Kategorizimi në bazë të etnisë | 24 |
| Figura 21. A mund të na tregoni cilat platforma private përdorni për të gjetur vende të lira pune?... .. | 25 |
| Figura 22. Në cilin portal pune vizitoni më shpesh për të gjetur vende të lira pune? | 25 |
| Figura 23. Në cilin portal pune vizitoni më shpesh për të gjetur vende të lira pune? Kategorizimi sipas moshës..... | 26 |
| Figura 25. Çfarë pozite keni në biznesin tuaj? | 26 |
| Figura 24. Çfarë madhësie ka kompania juaj? | 26 |
| Figura 26. Cilën nga metodat e mëposhtme përdorni më së shpeshti për të rekrutuar stafin tuaj?..... | 28 |
| Figura 27. A mund të na tregoni se cilin portal punësimi përdorni për të publikuar vendet e lira të punës? | 28 |

| | |
|--|----|
| Figura 28. A mund të na thoni avantazhet e përdorimit të platformave private (TV, Radio, Portalet e Punësimit) për qëllime rekrutimi në krahasim me shërbimet e ofruara nga Agjencia e Punësimit?... | 29 |
| Figura 29. Sa punonjës të rinj keni punësuar në kompaninë tuaj në vitin 2019? | 30 |
| Figura 30. Sa prej tyre keni punësuar me ndërmjetësimin e Agjencisë së Punësimit? | 30 |
| Figura 31. Në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 = aspak i informuar dhe 5 = shumë i informuar, sa të informuar jeni për shërbimet e mëposhtme të Agjencisë së Punësimit?..... | 31 |
| Figura 32. A keni qenë në gjendje të gjeni të gjitha informacionet që ju nevojiten për shërbimet / skemat e ofruara nga Agjencia e Punësimit (në lidhje me procedurat, dokumentacionin, etj)? | 32 |
| Figura 33. Gjatë vitit 2019, a keni pasur ndonjë bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit për ndonjë nga shërbimet e mëposhtme?..... | 33 |
| Figura 34. Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me secilin shërbim që keni marrë nga Agjencia e Punësimit | 34 |
| Figura 35. Gjatë vitit 2019, a keni punësuar ndonjë punëtor që ka kryer ndonjë trajnim profesional në Qendrën e Aftësimin Profesional? | 35 |
| Figura 36. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me punonjësit tuaj të trajnuar në Qendrën e Aftësimin Profesional?..... | 36 |
| Figura 37. Në përgjithësi, sa jeni të kënaqur me njohuritë e treguara nga punonjësit tuaj që kanë kryer trajnim profesional në Qendrat e Aftësimin Profesional? | 36 |
| Figura 38. A keni dëgjuar ndonjëherë për platformën (faqen e internetit) të Agjencisë së Punësimit së Kosovës, në të cilën botohen vendet e lira të punës dhe CV-të e të papunëve? | 37 |
| Figura 39. Sa shpesh vizitoni uebfaqen e Agjencisë së Punësimit për të gjetur punonjës të mundshëm? | 37 |
| Figura 40. Sa e dobishme mendoni se është kjo platformë/faqe në internet për gjetjen e fuqisë punëtore të kualifikuar?..... | 38 |
| Figura 41. Sipas mendimit tuaj, si mund të përmirësohen shërbimet e Zyrës së Punësimit? | 38 |
| Figura 42. Bazuar në përvojën tuaj me Zyrën e Punësimit, do t'i rekomandonit bizneset e tjera që të bashkëpunojnë me Agjencinë e Punësimit? | 39 |

Përmbledhja ekzekutive

Studimi "Analiza e hulumtimit mbi kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëkërkuar dhe punëdhënës në Kosovë¹ nga Agjencia e Punësimit të Kosovës mbështetet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë përmes projektit Programet Aktive të Tregut të Punës 2 (ALMP) dhe është zbatuar nga UBO Consulting, me qëllim të identifikimit të situatës aktuale në nivelin e kënaqësisë së punëkërkuarve dhe bizneseve që kanë bashkëpunuar me Agjencinë e Punësimit. Ky hulumtim ka adaptuar një metodologji sasiore dhe cilësore. Metodologjia sasiore u aplikua duke përdorur dy pyetësorë: një për punëkërkuar, me ç'rast janë anketuar 1,022 respondentë dhe një për bizneset, duke anketuar 201 përfaqësues të biznesit. Metodologjia cilësore u realizua nga 20 intervista të thella me përfaqësuesit e biznesit, për të marrë një këndvështrim më të mirë në lidhje me bashkëpunimin e bizneseve.

Seksioni vijues nxjerrë në pah gjetjet kryesore të mbledhura nga rezultatet e pyetësorëve dhe intervistave të thella.

Gjetjet kryesore për Punëkërkuarët:

- Sipas 64 % të të anketuarve, burimi kryesor i informacionit për Agjencinë e Punësimit janë familja dhe miqtë. Për më tepër, 15 % kanë dëgjuar për agjencinë përmes njerëzve që ishin të regjistruar tashmë në Agjencinë e Punësimit, dhe 13 % kishin dëgjuar për të në mediat sociale.
- Shërbimi më i popullarizuar i ofruar nga Agjencia e Punësimit, me të cilin punëkërkuarët ishin më të informuar, ishte ndërmjetësimi i punësimit / gjetja e një pune (90%), e përcjellur nga sigurimi i formimit profesional (72%) dhe praktikës (62%).
- Arsyeja kryesore pse të anketuarit ishin regjistruar në Agjencinë e Punësimit ishte sigurimi i një vendi pune (71%).
- Shumica e të anketuarve (40%) morën pjesë në trajnimet profesionale të ofruara nga Agjencia e Punësimit, specifikisht nga Qendrat e Aftësimit Profesional. Trajnimet më të ndjekura ishin trajnimi i gatimit (28%) dhe trajnimi i rrobaqepësisë (24%). Shumica e të anketuarve pohuan se trajnerët ishin të përgatitur mirë për temën e trajnimit.
- Shumica e të anketuarve (66%) kanë dëgjuar për uebfaqen e Agjencisë së Punësimit të Kosovës në të cilën janë publikuar vendet e lira të punës dhe 77 % e konsiderojnë të dobishme.
- Disa nga rekomandimet për Agjencinë e Punësimit ishin të sigurojnë më shumë informacione për vendet e lira të punës (52%), të krijojnë shërbime të reja punësimi (50%) dhe të organizojnë panairë të punës (42%).
- Të anketuarit ishin kryesisht të kënaqur me shërbime siç janë trajnimi profesional (86%), gjetja e vendeve të punës (83%) dhe praktikën në punë (78%). Sa i përket kënaqshmërisë me punonjësit që punojnë në Agjencinë e Punësimit, në një shkallë nga 1 (aspak të kënaqur) në 5 (shumë të kënaqur), niveli i kënaqshmërisë së të anketuarve ishte 4.45. Në përgjithësi, shumica e të anketuarve (87%) do të rekomandonin njerëz të papunë të regjistroheshin në këtë agjenci.
- Përveç përdorimit të shërbimeve të Agjencisë së Punësimit si institucioni kryesor ndërmjetësues i punës në Kosovë, rreth një e treta e të anketuarve deklaruan se ata përdorin portalet e punës për

¹ Referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

të gjetur vendet e lira të punës; kryesisht Gjirafa.com (18%), Portalpune.com (13%) dhe Kosovajob.com (12%).

Gjetjet kryesore për Përfaqësuesit e Bizneseve:

- Bazuar në intervistat me përfaqësuesit e biznesit, Agjencia e Punësimit ka ndihmuar bizneset që të punësojnë punonjës të rinjë, praktikantë dhe të zgjerojnë perspektivën e biznesit.
- Shumica e bizneseve të intervistuar raportuan se ishin të kënaqura me Agjencinë e Punësimit, pasi shërbimet e tyre kanë qenë mjaft të dobishme për biznesin e tyre. Sidoqoftë, kishte edhe disa përfaqësues që nuk ishin të kënaqur me këtë agjenci, përkatësisht për shkak të mungesës së transparencës dhe natyrës burokratike të saj.
- Metoda që bizneset e anketuara përdorin kryesisht për rekrutimin e stafit është përmes rekomandimeve nga miqtë, kolegët ose anëtarët e familjes (77%).
- Portalet e punësimit që bizneset në anketë i përdorin për të publikuar vendet e lira të punës janë Portalpune.com (47%), Kosovajob.com (29%) dhe Gjirafa.com (12%). Në anën tjetër, bizneset e intervistuar përdorin kryesisht media sociale. Arsyet kryesore pse ata përdorin platforma private në vend të Agjencisë së Punësimit është sepse ato platforma ofrojnë më shumë informacion për punëkërkesit (40%), kanë një shtrirje më të gjerë (40%) dhe ofrojnë mënyra më të shpejta për të gjetur punonjës (35%).
- Shumica e bizneseve në anketë (63%) pohuan se ata nuk kanë punësuar asnjë punonjës përmes ndërmjetësimit të Agjencisë së Punësimit.
- Në një shkallë nga 1 (aspak të informuar) deri në 5 (shumë të informuar), përfaqësuesit e biznesit në anketë ishin të informuar kryesisht për ndërmjetësimin / gjetjen e punonjësve (3.33) dhe praktikën (3.28).
- Bizneset e intervistuar në këtë anketë bashkëpunojnë me Agjencinë e Punësimit kryesisht për ndërmjetësimin/gjetjen e të punësuarve (71%) ose praktikave në punë (55%). Sidoqoftë, bizneset e shumicës në anketë (63%) pohuan se ata nuk kanë punësuar asnjë punonjës përmes ndërmjetësimit të Agjencisë së Punësimit.
- Në përgjithësi, bizneset ishin shumë-/disi të kënaqur me shërbimet e Agjencisë së Punësimit, të tilla si trajnimi për punë (90%), praktika në punë (85%), subvencionet për paga (83%) dhe ndërmjetësimi i punësimit (70%).
- Shumica e bizneseve (81%) pohuan se nuk kanë punësuar asnjë punonjës që ka kryer ndonjë trajnim profesional në Qendrën e Aftësisit Profesional. Në mënyrë të ngjashme, 18 biznese të intervistuar kanë thënë se nuk kanë punësuar punonjës të trajnuar nga Agjencia e Punësimit, duke lënë kështu vetëm dy prej tyre që e kanë bërë një gjë të tillë.
- Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë dëgjuar për uebfaqen e Agjencisë së Punësimit (59%) dhe e kanë parë atë si disi të dobishme (56%).
- Rekomandimet për Agjencinë e Punësimit nga përfaqësuesit e biznesit në këtë studim ishin të organizojnë më shumë panairë pune (51%), të krijojnë shërbime të reja punësimi (48%) dhe të krijojnë partneritete me më shumë biznese (46%). Të intervistuarit rekomanduan përfshirjen e praktikës profesionale pas trajnimeve dhe zgjerimin e trajnimeve të tyre në fusha të ndryshme.
- Shumica e të anketuarve (88%) deklaruan se do t'a rekomandonin Agjencinë e Punësimit tek bizneset e tjera.

Hyrje

Agjencia e Punësimit e Kosovës është një agjenci e pavarur e krijuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) me qëllim të administrimit të tregut të punës dhe zbatimit të politikave të punësimit dhe aftësimit profesional. Me krijimin e Agjencisë së Punësimit të Kosovës (APK), shërbimet publike të punësimit ndahen nga MPMS, me qëllim të administrimit të tregut të punës dhe zbatimit të politikave të punësimit dhe aftësimit profesional. Si e tillë, agjencia organizon dhe koordinon planifikimin vjetor të aktiviteteve dhe nismave për zbatimin e politikave vjetore të punësimit dhe formimit profesional.

Poashtu, Agjencia e Punësimit e Kosovës menaxhon tetë Qendra të Aftësimit Profesional (QAP) të cilat janë të koncentruara në shtatë rajonet e Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjiilan, Mitrovicë dhe Dolan (pjesa veriore e Mitrovicës) me 69 punëtorë dhe 30 profesione të ndryshme. Në këto qendra bëhet aftësimi dhe ri-aftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkues, të papunë dhe ata që marrin shërbimet për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të Punësimit nëpër komuna.

Agjencia e Punësimit e Kosovës ka katër objektiva kryesore:

- Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve publike të punësimit;
- Reformimi i shërbimeve të trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut të punës;
- Zgjerimi i përfshirjes dhe rritja e efikasitetit të masave aktive të tregut të punës;
- Zhvillimi dhe përmirësimi i aspekteve të ndryshme të analizës së tregut të punës.

Ky studim "Analizë kërkimore për kënaqshmërinë e ofrimit të shërbimeve të punësimit për punëkërkues dhe punëdhënës nga Agjencia e Punësimit" është kryer me qëllim të matjes së opinionit publik për kënaqshmërinë e ofrimit të këtyre shërbimeve në Kosovë. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte identifikimi i situatës aktuale në nivelin e kënaqshmërisë të punëkërkuesve dhe bizneseve që bashkëpunojnë me Agjencinë e Punësimit për ofrimin e shërbimeve të punësimit të ofruara nga kjo agjenci. Duke e ditur që shkalla e papunësisë në Kosovë në vitin 2019 ishte 29 %, nevoja për të siguruar rrugë më të mira dhe më të lehta për të papunët drejt gjetjes së një pune të përshtatshme për të punuar është thelbësore; prandaj, UNDP ka kërkuar një hulumtim në lidhje me këtë çështje, në mënyrë që të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të Agjencisë së Punësimit.

Hulumtimi sasior përfshin dy pyetësorë me pyetje në lidhje me shërbimet e Agjencisë së Punësimit, nivelin e kënaqshmërisë dhe rekomandimet për këtë agjenci; një për punëkërkues dhe një për ndërmarrjet e sektorit privat. Qëllimi ishte mbledhja e informacionit mbi arsyet pse punëkërkuesit dhe bizneset kanë vendosur t'i drejtohen kësaj agjencie, nivelin e kënaqësisë me shërbimet e tyre dhe ndihmën që kjo agjenci u ka ofruar klientëve të saj. Për më tepër, pyetësorët kanë përfshirë pyetje që u dhanë mundësinë punëkërkuesve dhe bizneseve të japin rekomandime për përmirësimin e shërbimeve të Agjencisë së Punësimit. Gjetjet e hollësishme të cilat synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve të kësaj agjencie janë paraqitur në pjesën e Rezultateve të Studimit më poshtë.

Për më tepër, pjesa cilësore e studimit është realizuar me përfaqësues të bizneseve në Kosovë. Intervistat e hollësishme u bazuan në një udhëzim të strukturuar dhe intervistat shërbyen për të mbledhur më shumë informacione të detajuara rreth bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe Agjencisë

Kosovare të Punësimit dhe për të mbështetur / shtuar vlerën e të dhënave që rrjedhin nga pyetësi me bizneset.

Metodologjia

Hulumtimi aktual ka aplikuar një metodologji sasiore dhe cilësore. Metodologjia sasiore u realizua duke përdorur dy pyetësorë, një për punëkërkuar dhe një për bizneset, i përbërë nga pyetje të hapura dhe pyetje të mbyllura. Pyetjet e hapura u zbatuan më së shumti kur mendimi i respondentit nuk ishte në opsionet e dhëna në pyetjet me zgjedhje të shumfishtë, ose kur u kërkohej të jepnin shpjegime shtesë pasi të zgjidhnin një përgjigje të veçantë. Nga ana tjetër, metodologjia cilësore u zbatua duke zhvilluar 20 intervista të hollësishme telefonike me përfaqësuesit e ndërmarrjeve të sektorit privat.

Metodologjia Sasiore

Metodologjia për Anketën me Punëkërkuar

Pjesa sasiore e studimit të zhvilluar me punëkërkuar përfshinte gjithsej 1,022 të anketuar (të regjistruar në Agjencinë e Punësimit) në të 38 komunat e Kosovës. Kjo mostër është llogaritur të jetë proporcionale për secilën kategori, bazuar në të dhënat e mbledhura nga Agjencia e Punësimit prej raportit "Puna dhe Punësimi 2019". Kjo mostër është llogaritur duke marrë parasysh nivelin e besimit prej 95% dhe marzhën e gabimit prej 3% për të gjithë mostrën dhe është përfaqësues i popullatës së synuar.

Pyetësi "Opinionioni Publik mbi Shërbimet e Agjencisë Kosovare të Punësimit" për punëkërkuar u administrua përmes intervistuesve të thirrjeve telefonike, duke përdorur teknikën e intervistimit telefonik të ndihmuar nga kompjuteri (CATI). Në teknikën CATI, anketa bëhet përmes thirrjeve telefonike dhe të dhënat përpunohen përmes një programi të menaxhimit të anketës - ASKIA. Anketimi i popullatës përmes thirrjeve telefonike në Kosovë është një metodë e besueshme e anketimit pasi depërtimi i telefonisë celulare dhe fikse në Kosovë është shumë i lartë. Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) raporton se në tremujorin e fundit të vitit 2019 kishte 2,073,873 përdorues të telefonisë celulare dhe 55,825 përdorues të linjës fikse në Kosovë, gjë që tregon një shkallë shumë të lartë të depërtimit të telefonisë.

Pyetësi i realizuar me punëkërkuar përbëhej nga 22 pyetje në total, katër prej të cilave ishin pyetje demografike. Pyetësi ishte krijuar për të matur kënaqshmërinë e përgjithshme të punëkërkuarve në lidhje me shërbimet e ofruara nga Agjencia Kosovare e Punësimit. Anketa është implementuar në 38 komuna në tërë Kosovën. Të anketuarit u zgjedhën rastësisht: çdo i treti në bazën e të dhënave të Agjencisë së Punësimit. Për më tepër, pasi që një studim kishte si synim punëkërkuar, mosha e tyre duhej të ishte mbi 18 vjeç. Ju lutemi gjeni pyetësin të bashkëlidhur në [Shtojcën A](#) në fund të raportit.

Metodologjia për Anketën me Përfaqësuesit e Bizneseve

Pyetësi për bizneset u zhvillua me 201 përfaqësues të ndërmarrjeve private. Kjo mostër është llogaritur të jetë proporcionale për secilën kategori, bazuar në bazat e të dhënave të bizneseve që kanë përdorur shërbimin "Ndërmjetësimi në punësim të rregullt" dhe / ose "Masat aktive të punës". E gjithë mostra ka një nivel besimi prej 95% dhe një marzhë gabimi prej 3%. Për më tepër, përderisa mostra është marrë nga baza e të dhënave të bizneseve që kanë përdorur Agjencinë e Punësimit të Kosovës, mostra është përfaqësuese për popullatën e synuar.

Pyetëtori "Opinionioni Publik mbi Shërbimet e Agjencisë së Punësimit të Kosovës" për bizneset u administrua gjithashtu përmes intervistuesve të thirrjeve telefonike, duke përdorur teknikën e intervistimit telefonik të ndihmuar nga kompjuteri (CATI). Popullata e synuar për këtë studim është marrë nga baza e të dhënave të bizneseve të regjistruara në Agjencinë e Punësimit. Ky pyetësor u implementua gjithashtu në 38 komuna të Kosovës.

Pyetëtori për përfaqësuesit e biznesit përbëhet nga 23 pyetje, pesë prej të cilave ishin pyetje demografike. Pyetëtori ishte krijuar për të matur kënaqshmërinë e bizneseve sa i përket shërbimeve të Agjencisë së Punësimit të Kosovës. Ju lutemi gjeni pyetësin bashkëlidhur në [Shtojcën B](#) në fund të raportit.

Finalizimi i Pyetësorëve

Për të identifikuar problemet e mundshme që mund të shfaqen gjatë administrimit të pyetësorëve në terren, u zhvillua një pilot-testim i pyetësorëve për t'i vërtetuar ato për sa i përket përmbajtjes dhe logjikës. Pilot testimi lejoi që të përcaktohet siguria e pyetësorëve, si dhe të matet koha e nevojshme për të përfunduar me sukses një intervistë. Modifikimet e nevojshme iu bënë pyetësorëve gjatë kësaj faze, duke përfshirë: redaktimin ose riformulimin e pyetjeve, shtimin e filterëve në pyetje të caktuara, shtimin e pyetjeve të reja etj. Për më tepër, ndryshimet në pyetje u pasqyruan në tri gjuhët e punës: anglisht, shqip dhe serbisht.

Rekrutimi dhe Trajnimi i Ekipit të Anketimit

Ekipi operativ u zgjodh me kujdes, duke i'u dhënë përparësi hulumtuesve me përvojë. Ekipi i punës në terren përbëhet nga 14 anketues, dy mbikëqyrës, një kontrollues teknik dhe një koordinator. Seancat e trajnimit u mbajtën më 14 prill, përmes video-konferencave, si me ekipin përgjegjës për studimin me punëkërkuarit, ashtu edhe me ekipin përgjegjës për studimin me bizneset.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte të sigurohej që anketuesit të kuptonin plotësisht pyetjet e anketës dhe terminologjinë, të njiheshin me metodologjinë e mostrave dhe intervistimit, si dhe të ishin intervistues efektivë që mund të administrojnë intervistat me lehtësi, saktësi, në mënyrë të vazhdueshme dhe të natyrshme.

Puna në terren dhe Kontrolli i cilësisë

Puna në terren zgjati prej 15 prillit deri më 1 maj 2020. Gjatë kësaj kohe janë zhvilluar dy anketa, një me punëkërkuarit dhe një me përfaqësues të ndërmarrjeve private.

Për kontrollin e cilësisë janë përkujdesur mbikëqyrësit në terren, të cilët ishin përgjegjës për kryerjen e kontrollit të parë të cilësisë duke ekzaminuar çdo pyetësor të paraqitur dhe personelin e futjes së të dhënave, të cilët ishin përgjegjës për kryerjen e nivelit të dytë të kontrollit të cilësisë, përderisa kontrollonin të dhënat në bazën elektronike të të dhënave.

Pastrimi, Tabulimi dhe Analiza e të Dhënave

Pastrimi dhe analiza e të dhënave për anketat sasiore janë realizuar në SPSS dhe tabelat janë gjeneruar sipas planit të analizës që është finalizuar nga ekipi i shkrimit të raportit. Profesionistët tanë me përvojë të vlerësimit të të dhënave u siguruan që të dhënat nuk përmbajnë ndonjë kod të padëshiruar, gabime, mospërputhje ose të dhëna të humbura.

Krostabulimet (tabelat e kryqëzuara) u krijuan për të zbuluar lidhjen midis të dhënave bazuar në një numër të variablave (ato relevante për objektivat e studimit). Për më tepër, ato u përdorën për të gjetur modele, trende dhe probabilitete brenda të dhënave të papërpunuara.

Metodologjia Cilësore

Për të marrë një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe për të kuptuar arsyet dhe argumentet prapa rezultateve të mbledhura nga anketa me bizneset dhe punëkërkuarit, janë realizuar 20 intervista të thella. Këto intervista janë realizuar në formën e intervistave të thella të strukturuar të cilat janë realizuar përmes telefonit nga anketuesit tanë, gjatë periudhës 11 - 15 maj, 2020. Ju lutemi, shihni [Shtojcën C](#) për listën e bizneseve të anketuara.

Intervistat e thella me bizneset synuan të sigurojnë një perspektivë më të mirë në lidhje me bashkëpunimin e bizneseve me Agjencinë e Punësimit dhe të identifikojnë hapat e nevojshëm për përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e efikasitetit të agjencisë. Intervista përbëhej kryesisht nga pyetje të hapura dhe disa pyetje të mbyllura dhe zgjati mesatarisht nga 20-25 minuta. Këto intervista të thella ndihmuan në marrjen e një perspektive të plotë nga përfaqësuesit e biznesit, e cila si shkëmbim jep një pasqyrë më të mirë në adresimin e shërbimeve të Agjencisë së Punësimit.

Më poshtë janë detajet e aktiviteteve të zhvilluara për këtë hulumtim cilësor:

Përbërja dhe aktivitetet për intervistat e thelluara:

- Me qëllim të marrjes së rezultateve më të mira bazuar në segmentimin e mostrës së anketës, numri i sugjeruar i intervistave të thelluara ishte 20;
- Intervistat e thelluara u realizuan me ndërmarrjet biznesore;
- Intervistat e thelluara u realizuan përmes thirrjeve telefonike (CATI).

Përparësitë e intervistave të thelluara

Në krahasim me fokus grupet, intervistat e thelluara ofrojnë disa përparësi, duke përfshirë:

- Arritjen e një audience më të gjerë - nuk ka kufizim sa i përket industrisë së vendndodhjes gjeografike;
- Marrjen e informacioneve më të thella - pjesëmarrësi i intervistave të thelluara ka vëmendjen e pandarë të intervistuesit dhe temat mund të eksplorojnë më në detaje;
- Është më e lehtë për pjesëmarrësit që të angazhohen në një intervistë të thelluar sesa në një fokus grup, pasi ka më shumë fleksibilitet në aranzhimin e saj.

Transkriptimi

Intervistat e thelluara u audio-regjistruan. Përgatitja e këtyre të dhënave të regjistruara për analizë kërkonte transkriptimin e të gjitha të dhënave.

- Intervistuesit morën shënime me shkrim për të dokumentuar një gamë të gjerë informacioni, duke përfshirë:
 - vëzhgime të rastësishme dhe të strukturuar;
 - citate me fjalë ose parafrazime të përgjigjeve të të intervistuarve;
 - pyetjet e hulumtuesve;

- pyetje, përfundime dhe vëzhgime të diskutuara gjatë seancave informuese të stafit.

Këto shënime janë shkruar në forma të standardizuara, në një formë të një transkripti duke ndjekur strukturën e pyetësorit. Pasi transkriptoi të gjitha regjistrimet përkatëse, transkriptuesi shtypi shënime korresponduese të intervistuesve të shkruara me dorë. Transkriptimi i regjistrimeve dhe shtypja e shënimeve të terrenit filluan menjëherë pas mbledhjes së të dhënave, gjatë 12-15 majit, 2020. Ju lutemi, shihni [Shtojcën D](#) për udhëzuesin e përdorur për intervista me përfaqësuesit e biznesit.

Rezultatet nga Anketa me Punëkërkuessit

Niveli i informacionit me Agjencinë e Punësimit të Kosovës

Qëllimi i parë i studimit ishte matja e nivelit të informacionit të punëkërkuessve për Agjencinë e Punësimit dhe shërbimet e ofruara prej tyre. Përveç kësaj, njohja e burimit të informacionit që punëkërkuessit përdorin për të hyrë në shërbimet e ofruara nga kjo agjenci, do të ndihmonte për të menaxhuar më mirë përhapjen e këtij informacioni dhe të arrihet një numër më i lartë i punë-kërkuessve të papunë.

Fillimisht, shumica e punëkërkuessve të anketuar pohojnë se burimi kryesor i informacionit për Agjencinë e Punësimit janë familja dhe miqtë (64%). Pas kësaj, 15 % e të anketuarve thonë se njerëzit që janë regjistruar tashmë në këtë agjenci, ua rekomanduan edhe atyre. Mediat sociale ishin një burim informacioni për 13 % të të anketuarve dhe 7 përqind mësuan për Agjencinë e Punësimit përmes TV-së, panairit e punës (2%) dhe radio stacionet (0.3%) shërbyen për të informuar më pak të anketuar në lidhje me agjencinë.




Figura 1. A mund të na tregoni se ku jeni informuar për Agjencinë e Punësimit?

Agjencia e Punësimit e Kosovës shërben për t'u ofruar punëkërkuesve të papunë një platformë të cilës mund t'i qasen në mënyrë që të gjejnë mundësi pune. Si e tillë, fokusi i tyre nuk shërben vetëm si ndërmjetës për punëkërkuesit dhe punëdhënësit e mundshëm, por gjithashtu për sigurimin e shërbimeve të ndryshme që u ofrojnë punëkërkuesve mundësinë për t'u trajnuar dhe pajisur plotësisht për pozicionet e mundshme të punës.

Në këtë aspekt, shumica e të anketuarve (90%) thanë se kanë dëgjuar se një shërbim i ofruar nga Agjencia e Punësimit është ndërmjetësimi i punësimit/gjetja e një pune. Për më tepër, shumica e të anketuarve deklaruan se agjencia siguron trajnime profesionale (72%), praktikë (62%) dhe trajnim në vend të punës (54%). Nga ana tjetër, më pak se gjysma e të anketuarve pohuan se ishin të vetëdijshëm se Agjencia e Punësimit siguron subvencion pagash (45%), angazhim në punë publike (43%) dhe vetëpunësim (41%).




Figura 2. A keni dëgjuar ndonjëherë për shërbimet / masat e mëposhtme të ofruara nga Zyrat e Punësimit?

Të anketuarit u pyetën më tej për arsyet që i nxitën ata të regjistroheshin në Agjencinë e Punësimit. Në këtë aspekt, shumica e të anketuarve thanë se ishin regjistruar sepse dëshironin të gjenin një vend pune (71%), pasuar nga 42 % që thanë se donin të ndiqnin trajnime profesionale. Sidoqoftë, një përqindje e ulët e të anketuarve thanë se ata i'u bashkuan Agjencisë së Punësimit për të përfituar nga shërbimet e ndihmës sociale (6%), një grant/projekt institucional (4%) ose një grant/projekt i një organizate ndërkombëtare (4%).




Figura 3. Cilat ishin arsyet që ju shtynë të regjistroheshi në Agjencinë e Punësimit?

Meqenëse të gjithë të anketuarit ishin regjistruar në Agjencinë e Punësimit, pyetja e mëposhtme u pyet për të kuptuar në lidhje me shërbimet që atyre i'u ofruan nga agjencia deri më tani. 40 % e tyre (40%) deklaruan se ata morën pjesë në trajnime profesionale të ofruara nga Agjencia e Punësimit. Rreth një e treta e të anketuarve (35%) nuk morën asnjë shërbim, edhe pse ata janë të regjistruar aty.

Për më tepër, një në pesë të anketuar (20%) ishin pjesë e masës së praktikës, 16 % gjetën punë përmes Agjencisë së Punësimit dhe 12 % ishin pjesë e masës së trajnimit në vend të punës. Nga ana tjetër, më pak të anketuar ishin pjesë e masës së subvencionimit të pagave (6%), masës së vetëpunësimit (6%) ose të angazhuar në punë publike (5%). 5 % tjetër përmendën shërbime të tjera si: ore mesimi gatimi, ndihmë me vizë pune ose që trajnimet për të cilat ata planifikonin të fillonin nuk mund të fillonin për shkak të situatës globale të pandemisë.




Figura 4. Cfarë shërbime keni marr nga Agjencia e Punësimit?

Masat e marra nga Agjencia e Punësimit e Kosovës

Trajnimet profesionale

Në mesin e shumë trajnimeve profesionale të ofruara nga Agjencia e Punësimit, rezultatet tregojnë se më shumë të anketuar kanë marrë trajnime për gatime (n = 28), rrobaqepësi (n = 24) dhe parukeri (n = 18). Pas kësaj, 17 të anketuar morën pjesë në trajnime për saldime, 16 për IT dhe instalime elektrike, dhe 12 për ndërtim dhe mikpritje. Figura e mëposhtme përshkruan trajnime të tjera të përmendura nga më pak të anketuar.




Figure 5. Çfarë trajnime profesionale keni ndjekur?

Për më tepër, atyre që morën trajnime profesionale nga Agjencia e Punësimit i'u kërkua më tej të deklarojnë nëse pajtohen ose nuk pajtohen me disa deklaratat. Në përgjithësi, shumica e të anketuarve janë pajtuar me deklaratat e mëposhtme. Specifikisht, 80 % thanë se pajtohen që personat që kanë ofruar trajnim ishin të përgatitur mirë për temën e trajnimit, dhe 79 % ranë dakord se puna praktike gjatë trajnimit ka rritur kapacitetet e tyre profesionale. Sidoqoftë, më pak të anketuar (71%) plotësisht ranë dakord që trajnimi i ndihmoi ata të gjejnë punë.




Figura 6. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Trajnim profesional

Skema e Subvencionimit të Pagave

Njësoj, të anketuarit që ishin pjesë e skemës së subvencionimit të pagave vlerësuan deklaratat e mëposhtme. Në këtë aspekt, më shumë të anketuar pranuan që ata ishin paguar me kohë gjatë skemës (77%) dhe se ata ishin paguar sipas kontratës (72%). Më pak të anketuar pranuan që subvencionet për paga kanë ndikuar që ata të gjejnë një punë të qëndrueshme (67%) dhe se gjatë skemës, ata u udhëzuan nga zyrtarët e punësimit në një biznes që lidhet me profesionin e tyre (64%).




Figura 7. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Skema e subvencioneve të pagave

Masa e Praktikës dhe Masa e Trajnimit në Vendin e Punës

Shumica e respondentëve të cilët ishin përfitues të masës së praktikës pohuan se pajtohen se trajnerët/mentorët u ofruan njohuritë që do u nevojiten në profesionin e tyre të ardhshëm (88%) dhe se gjatë praktikës, ata kanë ngritur kapacitetet e tyre profesionale (83%). Më pak respondentë (75%) u pajtuan se periudha e praktikës ishte në përputhje me pritjet e tyre.




Figura 8. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Masa e praktikës

Për më tepër, më shumë pajtim u shpreh nga respondentët kur deklaratat e mëposhtme përmendeshin lidhur me masën e trajnimit në vendin e punës. Në këtë aspekt, më shumë se 80 % pajtoheshin se trajnerët/mentorët u kanë ofruar atyre njohuri që do u nevojiten për profesionin e tyre të ardhshëm (88%), gjatë trajnimit ata kanë ngritur kapacitetet e tyre profesionale (85%) dhe se periudha e trajnimit në vendin e punës ishte në përputhje me pritjet e tyre (83%).




Figura 9. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Masa e trajnimit në vendin e punës

Kur krahasojmë përfituesit e trajnimeve të ndryshme të ofruara nga Agjencia e Punësimit, më shumë prej tyre që ishin pjesë e masës së vetëpunësimit nuk ishin dakord me deklaratat e lexuara për ta. Më konkretisht, e njëjta përqindje e të anketuarve (39%) nuk ishin dakord që granti (me para ose pajisje) që ata kanë marrë ka qenë në përputhje me profesionin e tyre, i ka ndihmuar ata të krijojnë një punësim të qëndrueshëm ose ka përmbushur nevojat e planit të tyre të biznesit. Sidoqoftë, pak më shumë u pajtuan që granti që morën ishte në përputhje me profesionin e tyre (53%).




Figura 10. A pajtoheni me deklaratat e mëposhtme në lidhje me trajnimin ku morët pjesë? Masa e vetëpunësimit

Kënaqshmëria me Shërbimet dhe Punonjësit e Agjencisë së Punësimit të Kosovës

Nga të gjitha shërbimet e ofruara nga Agjencia e Punësimit, më shumë të anketuar deklarojnë se janë shumë / mesatarisht të kënaqur me trajnimin profesional (86%) dhe gjetjen e vendeve të punës (83%). Për më tepër, 78 % deklaruan se ishin shumë / disi të kënaqur me praktikën dhe 72 % me trajnime në vend të punës. Nga ana tjetër, 54 % e të anketuarve pohuan se ishin shumë / disi të kënaqur me subvencionin e pagave, dhe më pak se gjysma e të anketuarve thanë të njëjtën gjë për vetëpunësimin (49%) dhe punën publike (41%).




Figura 11. A mund të na tregoni se sa jeni të kënaqur jeni me secilin shërbim që keni marrë nga Zyrat e Punësimit?

Ata që pretenduan se ishin shumë / disi të pakënaqur me shërbimet e ofruara nga Agjencia e Punësimit, u kërkua më tej të shprehin arsyen e pakënaqshmërisë së tyre. 1 %, që thanë se ishin të pakënaqur me aftësimin profesional, ishte sepse ata nuk lejoheshin të ndiqnin tërë trajnimin, nuk i'a ka vlejtur koha e dedikuar për trajnim, ose se nuk kishte ndonjë rregull pune. Për më tepër, paga e ulët ishte arsyeja pse të anketuarit ishin të pakënaqur me subvencionin e pagave, dhe puna pa kontratë shkaktoi pakënaqësi për gjetjen e vendeve të punës. Sa i përket praktikës, të anketuarit nuk deklaruan arsytet e pakënaqësisë së tyre.

Kur bëhet fjalë për nivelin e kënaqshmërisë me punonjësit që punojnë në Agjencinë e Punësimit, në një shkallë nga 1 (aspak të kënaqur) deri në 5 (shumë të kënaqur), të anketuarit raportuan një nivel më të lartë të kënaqësisë me sjelljen e stafit nga Agjencia e Punësimit (4.45), pasuar nga gatishmëria e stafit për të dëgjuar nevojat e të papunëve (4.21). Më pak kënaqësi u shpreh ndaj punonjësve të Agjencisë së Punësimit, në aspekt të sigurimit të informacionit për vendet e lira të punës (3.84) dhe këshilla profesionale (3.83).




Figura 12. A mund të na tregoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë me aspektet e mëposhtme në lidhje me punonjësit që punojnë në Zyrën e Punësimit?

Duke i klasifikuar nga etnia, mund të vërejmë dallime në të gjitha rastet. Në përgjithësi, shqiptarët e Kosovës dhe pakicat tjera raportojnë më shumë kënaqshmëri me të gjitha aspektet vijuese, sesa serbët e Kosovës. Për shembull, përderisa shqiptarët vlerësojnë nivelin e tyre të kënaqshmërisë me qëndrimin e stafit të Agjencisë së Punësimit në 4.55 (në një shkallë nga 1 që do të thotë "aspak i kënaqur" në 5 që do të thotë "shumë i kënaqur"), të tjerët e vlerësojnë atë 4.70 kurse serbët e vlerësojnë atë vetëm 3.37.




Figura 13. A mund të na tregoni nivelin tuaj të kënaqshmërisë me aspektet e mëposhtme në lidhje me punonjësit që punojnë në Zyrën e Punësimit? Klasifikimi sipas etnisë

Uebfaqja e Agjencisë së Punësimit të Kosovës

Agjencia e Punësimit ka një uebfaqe në internet ku punëkërkuessit mund të gjejnë më shumë informacione rreth agjencisë, shërbimeve të tyre, trajnimeve dhe vendeve të lira të punës. Megjithatë, një në tre të anketuar (34%) deklaruan se kanë dëgjuar për uebfaqen, e cila lë një shumicë (66%) të cilët nuk kanë dëgjuar për të.




Figura 14. A keni dëgjuar për platformën (uebfaqen) e Agjencisë së Punësimit të Kosovës, në të cilën publikohen vendet e lira të punës?

Ata që kanë dëgjuar për uebfaqen e Agjencisë së Punësimit janë pyetur se sa shpesh e vizitojnë atë për të gjetur vende të lira potenciale të punës. Më shumë të anketuar (43%) pohuan se ata rrallë/kurrë nuk vizitojnë faqen e internetit të agjencisë, ndërsa 28 % e vizitojnë atë shumë shpesh/gjithmonë. Më pas, 30 % deklaruan se ata vizitojnë uebfaqen vetëm ndonjëherë.




Figura 15. Sa shpesh vizitoni uebfaqen e Agjencisë së Punësimit për të gjetur vende të lira të punës?

Të kategorizuar nga grupmosha, mund të vërejmë që më shumë të anketuar të moshës 25-34 vjeç (31%) vizitojnë gjithmonë / shumë shpesh faqen e internetit të Agjencisë, pasuar nga ata të moshës 18-24 vjeç (26%) dhe 45-54 (26%). Shumica e të anketuarve të moshës 55-64 vjeç (80%) thonë se ata rrallë / asnjëherë nuk vizitojnë faqen e internetit të Agjencisë së Punësimit për të kërkuar vende të lira pune.




Figura 16. Sa shpesh vizitoni Uebfaqen e Agjencisë së Punësimit për t'u njoftuar për vendet e lira të punës? Kategorizimi në bazë të moshës

Për më tepër, shumica e atyre që vizituan uebfaqen e Agjencisë së Punësimit e konsiderojnë atë shumë/disi të dobishme (94%) për të papunët. Nga ana tjetër, 6 % deklaruan se ishte shumë/disi e padobishme. Ata pak që e gjetën të padobishme faqen në internet, kryesisht thanë se ishte sepse nuk ju ndihmon të gjejnë një vend pune, ose që ata rrallë e vizitojnë atë.




Figura 17. Sa e dobishme mendoni se kjo platformë / faqe në internet është për të papunët?

Komentet Përfundimtare për Agjencinë e Punësimit të Kosovës

Duke përmbyllur diskutimin për Agjencinë e Punësimit, ishte e rëndësishme të merren parasysh gjërat që punëkërkuuesit e regjistruar në agjenci sugjeruan se duheshin përmirësuar. Në këtë aspekt, rreth gjysma e të anketuarve deklaruan se Agjencia e Punësimit duhet të sigurojë më shumë informacione për vendet e lira të punës (52%) dhe të krijojë shërbime të reja punësimi (50%). Tutje, 42 % sugjeruan që agjencia të organizojë panairë të punës, dhe 40 % i rekomanduan krijimin e partneritetit me më shumë biznese.




Figura 18. Sipas mendimit tuaj, si mund të përmirësohen shërbimet e Zyrës së Punësimit?

Si përfundim, shumica e punëkërkuësve të anketuar (87%) pohuan se ata do t'iu rekomandojnë Agjencinë e Punësimit të papunëve, me qëllim që ata të regjistrohen për vendet e lira të punës dhe trajnime profesionale. Si rrjedhojë, 13 % deklaruan ndryshe.




Figura 19. Bazuar në përvojën tuaj me Agjencinë e Punësimit, a do të rekomandonit që të papunët të regjistrohen në këtë agjenci?

Të anketuarit nga etnitë e ndryshme kanë shprehur mendime të ndryshme nëse do ta rekomandojnë agjencinë tek njerëzit e papunë apo jo. Pjesa dërrmuese e punëkërkuësve K-Shqiptar (91%) thanë se do ta rekomandojnë atë, ashtu siç do të bënin edhe 79 % e K-Të tjerëve. Sidoqoftë, vetëm 44 % e K-Serbëve deklaruan të njëjtën gjë, shumica e të cilëve thonë të kundërtën (56%).




Figura 20. Bazuar në përvojën tuaj me Agjencinë e Punësimit, a do të rekomandonit që të papunët të regjistrohen në këtë agjenci? Kategorizimi në bazë të etnisë

Gjetja e vendeve të punës

Përveç Agjencisë së Punësimit, punëkërkuësit përdorin platforma të ndryshme për të gjetur mundësi pune. Siç përshkruajnë rezultatet më poshtë, një në çdo tre të anketuar (33%) thanë që ata përdorin portalet e punës për të gjetur vende të lira pune dhe 29 % përdorin portale elektronike. Pas kësaj, 19 % përdorin njoftimet nga TV dhe vetëm 4 % pohuan se përdorin njoftimet në gazeta ose në radio. Megjithatë, rreth një në katër të anketuar (26%) pohuan se nuk përdorin ndonjë platformë private për të kërkuar punë.




Figura 21. A mund të na tregoni cilat platforma private përdorni për të gjetur vende të lira pune?

Për më tepër, kur u pyetën se cilat portale të punës përdorin më shpesh respondentët për të gjetur vende të lira pune, një në katër prej tyre (24%) deklaruan se ata janë tashmë të punësuar dhe nuk kërkojnë punë nëpër portalet e punës, dhe 22 % deklaruan se nuk përdorin portalet e punës. Gjirafa është portali i punës më i përdorur, për 18 % të të anketuarve, pasuar nga Portalpune (13%), Kosovajob (12%) dhe Ofertapune (7%).




Figura 22. Në cilin portal pune vizitoni më shpesh për të gjetur vende të lira pune?

Ekzistojnë dallime midis grupmoshave të ndryshme kur bëhet fjalë për portalet e punës që ata përdorin më shpesh për të gjetur vende të lira pune. Të anketuarit e moshës 35 vjeç e lart nuk përdorin portalet e punës për të gjetur vende të lira pune, siç deklaruan shumica e të anketuarve të moshës 35-44 vjeç (32%), 45-54 (39%) dhe 55-64 (60%).

Nga ana tjetër, 18 % e të anketuarve të moshës 25-34 vjeç kryesisht përdorin portalpune dhe një në katër të anketuar të moshës 18-24 vjeç (25%) përdorin portalin Gjirafa për të mësuar për vendet e lira.




Figura 23. Në cilin portal pune vizitoni më shpesh për të gjetur vende të lira pune? Kategorizimi sipas moshës

Rezultatet nga Anketa dhe Intervistat e Thelluara me Përfaqësuesit e Bizneseve

Ky seksion përfshin rezultatet nga anketa si dhe intervistat e thelluara me përfaqësuesit e biznesit. Intervistat shërbejnë për të kompletuar informacionin e mbledhur në terren dhe për të mbështetur mendimet dhe rekomandimet e përfaqësuesve të bizneseve për Agjencinë e Punësimit.

Kryesisht, studimi përfshinte mikro bizneset (më pak se 10 persona) (88%). Në vijim, 7 % ishin përfaqësues të bizneseve të vogla (10-49 persona) dhe 5 % nga bizneset e mesme (50-249 persona). Shumica e të anketuarve të intervistuar për këtë pjesë të projektit ishin drejtorë / pronarë ekzekutiv (85%), pasuar nga 13 % menaxherë të biznesit dhe 2 % punonjës të tjerë të biznesit.




Figura 24. Cfarë madhësie ka kompania juaj?




Figura 25. Cfarë pozite keni në biznesin tuaj?

Nga ana tjetër, 20 intervista të thelluara u realizuan me bizneset. Shumica (n = 15) ishin biznese mikro, pasuar nga katër biznese të vogla dhe një biznes i mesëm. Tabela e mëposhtme paraqet mostrën e ndarë në komuna dhe sektorin e punës.

Tabela 1. Mostra e bizneseve të intervistuar

| | Komuna | Sektori |
|-----|------------------|--|
| 1. | Prishtinë | Industri Kozmetike |
| 2. | Prishtinë | Industri e Shërbimeve të Ushqimit |
| 3. | Prishtinë | Industria e Shërbimeve të Ushqimit |
| 4. | Gjilan | Industria Përpunuese |
| 5. | Gjilan | Turizëm dhe Sigurim shëndetësor |
| 6. | Gjilan | Sektori i IT |
| 7. | Ferizaj | Institucioni Arsimit |
| 8. | Ferizaj | Industria e Ndërtimitarisë |
| 9. | Ferizaj | Zyra Ligjore |
| 10. | Mitrovica Jugore | Industria e Makinave |
| 11. | Mitrovica Jugore | Industria Përpunuese |
| 12. | Mitrovica Jugore | Industria e shërbimeve ushqimore |
| 13. | Prizren | Industria e shitjes me pakicë |
| 14. | Prizren | Industria e shërbimeve ushqimore |
| 15. | Prizren | Industria e Ndërtimitarisë |
| 16. | Pejë | Zyra Ligjore |
| 17. | Pejë | Sektori i Konsultës Teknike dhe Inxhinierike |
| 18. | Pejë | Sektori Shëndetësor |
| 19. | Gjakovë | Industria e Përpunimit |
| 20. | Gjakovë | Industria e Floktarisë dhe Bukurisë |

Rekrutimi i Stafit

Fillimisht, përfaqësuesit e bizneseve në anketë u pyetën në lidhje me rekrutimin e stafit në bizneset e tyre. Kur u pyetën për metodat që ata përdorin më shpesh për rekrutimin e stafit, shumica e tyre (77%) thanë se marrin rekomandime nga miqtë / kolegët / anëtarët e familjes. Për më tepër, 36 % thanë se ata i publikojnë vendet e lira të punës në Agjencinë e Punësimit, ose në rrjetet sociale (34%).




Figura 24. Cilën nga metodat e mëposhtme përdorni më së shpeshti për të rekrutuar stafin tuaj?

Për të publikuar vendet e lira të punës, bizneset e këtij studimi përdorin kryesisht Portalpune (47%) si një portal punësimi. Portalet tjera të përdorura nga bizneset për të rekrutuar staf janë Kosovajob (29%), Gjirafa (12%) dhe Ofertapune (6%).




Figura 25. A mund të na tregoni se cilin portal punësimi përdorni për të publikuar vendet e lira të punës?

Rezultatet e intervistave të thelluara tregojnë dallime në pikëpamjet midis përfaqësuesve të bizneseve të ndryshme, në lidhje me kanalet e përdorura për rekrutim. Rreth gjysma e përfaqësuesve deklaruan se ata përdorin platforma të mediave sociale si mënyra më efektive dhe e lehtë për të rekrutuar punonjës të rinj. Për më tepër, u deklarua se për shkak të qasjes së lehtë, njoftimet në mediat sociale janë mënyra më e përshtatshme për bizneset pasi ndihmon për të rritur transparencën dhe për të arritur

një audiencë më të madhe. Gjithashtu, edhe gazetat u përmendën si një burim për tërheqjen e punonjësve të rinj.

“Në përgjithësi, pozicionet e lira të punës në kompaninë tonë publikohen përmes llojeve të ndryshme të mediave, siç janë media sociale. Unë besoj se kjo metodë është më e favorshme, për faktin se arrin një numër më të madh të kandidatëve të mundshëm. ”
Pronar nga Peja

Përveç mediave sociale, për përfaqësuesit e tjerë të biznesit metoda më e shpeshtë që përdoret për rekrutimin e punonjësve të rinj është skema e referimit të punonjësve dhe rekomandimet nga miqtë dhe familja. Përfaqësuesit e biznesit të cilët deklaruan se ata përdorin skemën e referimit të punonjësve raportuan se kjo mënyrë promovon më shumë pozitat e tyre të lira dhe është mënyra më e përshtatshme dhe e dobishme për rekrutimin e punonjësve të rinj, pasi që krijon një lidhje më të fortë midis biznesit të tyre dhe klientëve. Nga ana tjetër, përfaqësuesit që punësohen bazuar në rekomandimet e familjes dhe miqve të tyre deklaruan se kjo është mënyra më e sigurt për të rekrutuar një person profesional që është i përshtatshëm për pozicionin e punës.

Për më tepër, përfaqësuesit e bizneseve në anketim kanë shprehur mendimet e tyre në lidhje me përparësitë e përdorimit të platformave private (TV, Radio, Portalet e Punësimit) mbi shërbimet e ofruara nga Agjencia e Punësimit. Në këtë drejtim, 40 % e të anketuarve pohuan se platformat private ofrojnë më shumë informacion për punëkërkuuesit dhe se arrijnë të targetojnë më shumë njerëz. Për më tepër, 35 % thanë që platformat private ofrojnë një mënyrë më të shpejtë për të gjetur punonjës, dhe rreth një në tre të anketuar (34%) deklaruan se ata mund të arrijnë punëkërkuuesit që i duhen kompanisë së tyre.




Figura 26. A mund të na thoni avantazhet e përdorimit të platformave private (TV, Radio, Portalet e Punësimit) për qëllime rekrutimi në krahasim me shërbimet e ofruara nga Agjencia e Punësimit?

Shumica e bizneseve të anketuara (30%) pohuan se kanë punësuar një punëtor në vitin 2019. Një në pesë biznese (21%) kanë punësuar dy punonjës vitin e kaluar, dhe 12 % kanë punësuar 3-4 punonjës. Sidoqoftë, 27 % e bizneseve deklaruan se nuk punësuan asnjë punëtor gjatë vitit të kaluar.




Figura 27. Sa punonjës të rinj keni punësuar në kompaninë tuaj në vitin 2019?

Për më tepër, 63 % e bizneseve të anketuara thonë se nuk kanë punësuar asnjë punëtor me ndërmjetësimin e Agjencisë së Punësimit. Një në katër përfaqësues të biznesit (25%) deklarojnë se kanë rekrutuar një punëtor me ndihmën e agjencisë, 8 % kanë punësuar dy punonjës dhe 5 % kanë punësuar 3 ose më shumë punonjës.




Figura 28. Sa prej tyre keni punësuar me ndërmjetësimin e Agjencisë së Punësimit?

Niveli i informacionit në lidhje me shërbimet e Agjencisë së Punësimit të Kosovës

Përfaqësuesit e bizneseve në anketë u vlerësuan në nivelin e tyre të informacionit në lidhje me shërbimet e Agjencisë së Punësimit. Në një shkallë nga 1 në 5, ku 1 do të thotë aspak të informuar dhe 5 do të thotë shumë të informuar, të anketuarit ishin më të informuar në lidhje me ndërmjetësimin / gjetjen e punonjësve (3.33) dhe praktikën (3.28). Përkundrazi, ata raportuan se ishin më pak të informuar për vetëpunësimin (2.87) dhe punët publike (2.72).



